




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat Sociale

VLERËSIM

Popullsia e Kosovës 2021



Prishtinë, Qershor 2022



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat Sociale

VLERËSIM

Popullsia e Kosovës 2021



Botues: Agjencioni i Statistikës së Kosovës (ASK)
Data e botimit: Qershor, 2022
© Agjencioni i Statistikës së Kosovës
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.
Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes ueb-faqes së ASK-së:
<http://ask.rks-gov.net>

Parathënie

Vlerësimi i popullsisë së Kosovës është raport i rregullt vjetor që si qëllim ka të sigurojë një vlerësim statistikor për popullsinë, i nevojshëm për institucione, organizata dhe individë, njëkohësisht praktikë dhe standard që kërkohet të bëhet çdo vit nga institucionet zyrtare të statistikave të një vendi.

Në periudhën ndërmjet dy regjistrimeve (dhjetëvjeçare) ndodhin ndryshime të theksuara në popullsinë e një vendi, komune apo vendbanimi dhe vlerësimi i popullsisë është më se i nevojshëm për nxjerrjen e indikatorëve të rëndësishëm socio-ekonomik. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) do të vazhdojë të bëjë vlerësimin e numrit të popullsisë në nivel vendi dhe komune çdo vit. Të dhënat vjetore statistikore për popullsinë janë themelore për studimin dhe përcaktimin e një game të gjerë analizash të çështjeve sociale dhe ekonomike në nivele të caktuara komunale, kombëtare dhe rajonale.

Të dhënat për popullsinë janë një emërues dhe tregues i rëndësishëm i vendimmarrësve, analistëve, hulumtuesve dhe shfrytëzuesve të ndryshëm të të dhënave. Të dhënat për popullsinë përbëjnë komponentin thelbësor për vlerësimet e llogarive kombëtare, punësimit, ndarjeve buxhetore, standardit jetësor dhe çështjeve tjera socio-ekonomike.

Avni Kastrati	-	Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale/Popullsisë
Valdete Navakazi	-	Shefe e Divizionit të Statistikave të Popullsisë

Publikimin e përgatitën:

Arbert Abdyl	-	Zyrtar për Statistikat e Migrimit
Arijeta Sojeva	-	Zyrtare e Lartë e Statistikave Vitale
Saniye Uka	-	Zyrtare e Lartë e Statistikave të Popullsisë
Elvira Tahiri	-	Zyrtare e Statistikave të Popullsisë
Vjollca Berisha	-	Zyrtare e Statistikave Vitale

Zv. i Kryeshefit Ekzekutiv të ASK-së
Ilir Berisha

Lista e shkurtesave dhe simboleve

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
MPB	-	Ministria e Punëve të Brendshme
MPB	-	Ministria e Punëve të Brendshme
MASHTI	-	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
IOM	-	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
UNHCR	-	Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
EUROSTAT	-	Zyra Statistikore e Bashkimit Evropian
EFTA	-	Asociacioni i Tregtisë së Lirë të Evropës
0	-	E dhëna është më e vogël se 0,5 e njësisë së dhënë të matjes
:	-	Mungojnë të dhënat
-	-	Nuk ka dukuri

Përmbajtja

	Faqe
H Y R J E	8
Për shfrytëzuesit e të dhënave	8
Baza për vlerësimin e popullsisë	8
Vështrim metodologjik	8
Burimet e të dhënave	8
Popullsia bazë	9
Lindjet:	9
Vdekjet:	9
Shënim:	9
Shtimi natyror:	9
Migrimi	9
Imigrimi ndërkombëtar:	9
Emigrimi ndërkombëtar:	9
Migrimi kombëtar:	10
Rritja e përgjithshme	10
Tab. 1. Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror për vitin 2021 në nivel të komunave	11
Tab. 2. Gjithsej popullsia e Kosovës dhe migrimi për vitin 2021	12
Tab. 3. Gjithsej popullsia e Kosovës e vlerësuar për vitin 2021	12

HYRJE

Për shfrytëzuesit e të dhënave

Raporti përfshin ndryshimet e numrit të popullsisë (shtimin natyror dhe migrimin) gjatë periudhës 01 janar - 31 dhjetor 2021 në territorin e Kosovës.

Baza për vlerësimin e popullsisë

Për përgatitjen e këtij Vlerësimi, ASK-ja ka përdorur metodat të cilat praktikohen nga institucionet statistikore për vlerësimin e popullsisë duke shfrytëzuar burime të ndryshme.

Baza e të dhënave për vlerësimin e numrit të popullsisë në vitin 2021, është numri i vlerësuar i popullsisë rezidente në Kosovë, në fund të vitit 2020.

Vështrim metodologjik

Vlerësimi i numrit të popullsisë rezidente në nivel kombëtar/komunal ndikohet nga nataliteti, mortaliteti dhe migrimi (NMM).

Vlerësimi i popullsisë: popullsia bazë + nataliteti – mortaliteti ± migrimi i jashtëm/brendshëm.

Të dhënat e vlerësuara përfundimtare për numrin e popullsisë në nivel të komunave janë llogaritur sipas procedurave të mëposhtme:

$$P_n + (N - M) + (I - E)$$

P_n -Numri i banorëve të përlllogaritur për vitin e dhënë/paraprak (2020)

N -Numri i lindjeve të gjalla (Nataliteti), 01 janar-31 dhjetor 2021

M -Numri i vdekjeve (Mortaliteti), 01 janar-31 dhjetor 2021

I - Imigrimet, 01 janar-31 dhjetor 2021

E –Emigrimet, 01 janar-31 dhjetor 2021

Burimet e të dhënave

Në hartimin e këtij raporti janë shfrytëzuar burime të ndryshme statistikore si: Vlerësimi i vitit 2020, baza e të dhënave nga Regjistrimi i Popullsisë 2011, bazat e shënimeve nga Statistikat e Lindjeve dhe Vdekjeve (ASK), të dhënat administrative (përfshi bazat nga hulumtimet e ASK-së) të dhënat nga komunat e Kosovës, Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM-Zyra e Kosovës), Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR-Zyra e Kosovës), baza e shënimeve nga Eurostati, Frontex si dhe disa të dhëna preliminare nga shumë Institute statistikore ku ishte më i shprehur migrimi kosovar. Po ashtu, janë shfrytëzuar të dhënat e tjera administrative nga institucionet vendore, anketat, raportet dhe hulumtimet e tjera. Këto të dhëna janë analizuar sipas metodave statistikore, duke shërbyer si instrumente dhe shënime të rëndësishme statistikore për vlerësimin e numrit të popullsisë në nivel vendi dhe në nivel të komunave.

Popullsia bazë

Sipas "Vlerësimit të popullsisë për vitin 2020" numri i popullsisë rezidente në Kosovë në fund të vitit 2020 është vlerësuar gjithsej 1.798.186 banorë rezident, numër ky që është marrë si e dhënë bazike për të vlerësuar numrin e popullsisë për vitin 2021.

Lindjet- sipas të dhënave preliminare numri i lindjeve të gjalla për vitin 2021 që kishin deklaruar si vendbanim rezident Kosovën ishte gjithsej 29,236 lindje.

Vdekjet- numri i rasteve të vdekjeve në vitin 2021 që kishin deklaruar vendbanimin rezident në Kosovën ishte gjithsej 14,845 raste të vdekjeve.

Shënim: Tek rastet e lindjeve dhe vdekjeve nga komuniteti serb, një pjesë e tyre e konsiderueshme regjistrohet derisa, një pjesë e tyre (*sidomos komunat në pjesën veriore të Kosovës nuk i regjistrojnë/raportojnë rastet e lindjeve dhe vdekjeve*). ASK-ja në këtë raport nuk ka bërë vlerësim për komunitetin në fjalë për rastet e pa raportuara (nën-regjistrim).

Një numër i konsiderueshëm i rasteve të lindjeve dhe vdekjeve që ndodhin jashtë Kosovës, me rastin e regjistrimit të rasteve në zyrat e gjendjes civile, vendbanimin e tyre të përhershëm/rezident e deklarojnë në Kosovë. ASK-ja është e vetëdijshme se pjesa dërmuese e atyre rasteve që kanë ndodhur jashtë vendit nuk janë/ishin rezident në Kosovë por, në bazë të legjislacionit në fuqi ASK-ja nuk ka të drejtë të ndryshojë deklaratat e prindërve apo të të afërmeve për vendbanimin.

Rishikimi i rasteve të lindjeve dhe vdekjeve do të bëhet pas Regjistrimit të Popullsisë.

Shtimi natyror- popullsia e Kosovës gjatë vitit 2021 është rritur për 14,391 banorë.

Migrimi ndërkombëtar

Imigrimi ndërkombëtar- sipas të dhënave nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), komuna, UNHCR, IOM të dhënave nga disa komuna, të dhënave nga disa institute statistikore dhe të dhënave nga baza e të dhënave të Eurostatit, numri i imigrantëve në Kosovë, gjatë vitit 2021 ishte gjithsej 4,122 banorë. Në këtë numër janë përfshirë të kthyerit / riatdhesuarit, numri i azilkërkuesve në Kosovës që kanë fituar të drejtën e nënshtetësisë, si dhe të gjithë ata persona që kanë leje qëndrimi më shumë se një (1) vit qëndrimi në Kosovë (përfshirë punëtorët e studentët).

Emigrimi ndërkombëtar- numri i emigrantëve kosovarë gjatë vitit 2021 është vlerësuar të jetë gjithsej 42,728 banorë përfshirë emigrantët legalë dhe ata ilegalë.

Pjesa dërmuese e emigrantëve për vitin 2021 ishin emigrantët *legal*. Emigrimi legal ishte për shkak të: bashkimit familjar, martesave, gjetja e një vendi pune, shpërnguljes së përhershme (kryesisht në shtetet fqinje), studime afatgjata me punësim etj. Përveç vendeve të BE-së dhe EFTA-së një numër i kosovarëve kishte emigruar edhe në vende të tjera kryesisht në SHBA, Turqi, Kanada dhe vende tjera.

Migrimi ndërkombëtar i shprehur në vitin 2021 ishte edhe si pasojë e një numri të madh të emigrantëve që u kthyen në vitin 2020 (për shkak të Pandemisë COVID-19) sidomos nga Kroacia, Sllovenia, Mali i zi , Turqia e vende tjera të BE-së e që më pas emigruan përsëri në vitin 2021.

Bilanci i migrimit ndërkombëtar- në Kosovë për vitin 2021 ishte -38,606 banorë.

Migrimi kombëtar- gjatë vitit 2021, vlerësohet se një numër i konsiderueshëm i popullsisë rezidente në Kosovë ka ndërruar vendbanimin (komunën) për arsye të ndryshme kryesisht nga vendbanimet rurale në ato urbane dhe sub-urbane si dhe për shkak të martesave. Numri i personave që kanë ndërruar vendbanimin nga komuna e mëparshme (nga një komunë në komunën tjetër-brenda Kosovës) është vlerësuar të jetë gjithsej 7,353 banorë.

Rritja e përgjithshme

Shtimi natyror në Kosove në vitin 2021 ishte 14,391 banorë ndërsa migrimi neto -38,606 banorë. Popullsia e Kosovës gjatë vitit 2021 u zvogëlua për -24,215 banorë.

Tab. 1: Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror për vitin 2021 në nivel të komunave

Nr.	Komuna	Gjithsej popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2020)	Sipas vendbanimit të përhershëm në komunë			Gjithsej popullsia dhe shtimi natyror (31 dhjetor 2021)
			Lindjet / Nataliteti (2021)	Vdekjet / Mortaliteti (2021)	Shtimi natyror (2021)	
1	Deçan	42.480	554	279	275	42.755
2	Gjakovë	94.334	1.475	885	590	94.924
3	Glllogoc	61.145	1.119	325	794	61.939
4	Gjilan	77.145	1.385	900	485	77.630
5	Dragash	33.947	486	399	87	34.034
6	Istog	41.181	575	359	216	41.397
7	Kaçanik	34.672	557	241	316	34.988
8	Klinë	40.490	762	339	423	40.913
9	Fushë Kosovë	39.948	769	285	484	40.432
10	Kamenicë	27.948	428	359	69	28.017
11	Mitrovicë	69.331	1.152	617	535	69.866
12	Mitr. e Veriut	11.994	141	148	-7	11.987
13	Leposaviq	13.202	77	105	-28	13.174
14	Lipjan	57.928	1.099	426	673	58.601
15	Novobërdë	7.158	119	120	-1	7.157
16	Obiliq	18.218	434	233	201	18.419
17	Rahovec	57.047	971	443	528	57.575
18	Pejë	98.601	1.293	821	472	99.073
19	Podujevë	82.022	1.517	521	996	83.018
20	Prishtinë	218.781	3.173	1.631	1.542	220.323
21	Prizren	194.581	2.785	1.485	1.300	195.881
22	Skenderaj	52.714	892	329	563	53.277
23	Shtime	27.449	487	157	330	27.779
24	Shtërpcë	6.621	129	170	-41	6.580
25	Suharekë	58.195	1.164	481	683	58.878
26	Ferizaj	106.286	1.892	800	1.092	107.378
27	Viti	47.896	729	335	394	48.290
28	Vushtrri	62.925	1.153	605	548	63.473
29	Zubin Potok	6.664	52	66	-14	6.650
30	Zveçan	7.290	43	98	-55	7.235
31	Malishevë	57.261	1.244	351	893	58.154
32	Junik	6.383	67	46	21	6.404
33	Mamushë	5.874	100	25	75	5.949
34	Hani i Elezit	10.090	139	58	81	10.171
35	Graçanicë	12.230	152	233	-81	12.149
36	Ranillug	3.737	40	71	-31	3.706
37	Partesh	1.699	45	61	-16	1.683
38	Klllokot	2.719	37	38	-1	2.718
Gjithsej		1.798.186	29.236	14.845	14.391	1.812.577

Tab. 2: Gjithsej popullsia e Kosovës dhe migrimi për vitin 2021 në nivel të komunave

Nr.	Komuna	Popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2020)	Migrimi ndërkombëtar (2021)			Migrimi kombëtar (2021)			Balanci i përgjithshëm i migrimit në nivel të komunave 2021	Gjithsej popullsia dhe migrimi (31 dhjetor 2021)
			Imigrimi	Emigrimi	Bilanci i migrimit ndërkombëtar	Imigrimi	Emigrimi	Bilanci i migrimit kombëtar		
1	Deçan	42.480	59	289	-230	108	143	-35	-265	42.215
2	Gjakovë	94.334	247	2.265	-2.018	218	297	-79	-2.097	92.237
3	Glllogoc	61.145	91	1.175	-1.084	197	331	-134	-1.218	59.927
4	Gjilan	77.145	276	4.320	-4.044	258	326	-68	-4.112	73.033
5	Dragash	33.947	91	575	-484	52	120	-68	-552	33.395
6	Istog	41.181	103	406	-303	162	137	25	-278	40.903
7	Kaçanik	34.672	59	290	-231	93	183	-90	-321	34.351
8	Klinë	40.490	106	817	-711	185	212	-27	-738	39.752
9	Fushë Kosovë	39.948	163	1.936	-1.773	756	158	598	-1.175	38.773
10	Kamenicë	27.948	48	1.772	-1.724	116	243	-127	-1.851	26.097
11	Mitrovicë	69.331	132	1.693	-1.561	212	279	-67	-1.628	67.703
12	Mitr. e Veriut	11.994	20	124	-104	6	7	-1	-105	11.889
13	Leposaviq	13.202	49	344	-295	11	9	2	-293	12.909
14	Lipjan	57.928	127	1.186	-1.059	221	306	-85	-1.144	56.784
15	Novobërdë	7.158	18	132	-114	62	35	27	-87	7.071
16	Obiliq	18.218	41	1.177	-1.136	134	153	-19	-1.155	17.063
17	Rahovec	57.047	96	2.196	-2.100	132	216	-84	-2.184	54.863
18	Pejë	98.601	183	1.959	-1.776	234	260	-26	-1.802	96.799
19	Podujevë	82.022	231	2.195	-1.964	131	663	-532	-2.496	79.526
20	Prishtinë	218.781	470	2.625	-2.155	1.836	987	849	-1.306	217.475
21	Prizren	194.581	402	2.707	-2.305	553	323	230	-2.075	192.506
22	Skenderaj	52.714	87	531	-444	180	427	-247	-691	52.023
23	Shtime	27.449	105	927	-822	125	128	-3	-825	26.624
24	Shtërpcë	6.621	13	77	-64	32	45	-13	-77	6.544
25	Suharekë	58.195	85	2.542	-2.457	157	212	-55	-2.512	55.683
26	Ferizaj	106.286	346	2.201	-1.855	382	242	140	-1.715	104.571
27	Viti	47.896	111	870	-759	132	190	-58	-817	47.079
28	Vushtri	62.925	174	2.579	-2.405	205	259	-54	-2.459	60.466
29	Zubin Potok	6.664	9	53	-44	6	7	-1	-45	6.619
30	Zveçan	7.290	10	51	-41	7	9	-2	-43	7.247
31	Malishevë	57.261	131	2.339	-2.208	184	252	-68	-2.276	54.985
32	Junik	6.383	6	59	-53	29	21	8	-45	6.338
33	Mamushë	5.874	7	147	-140	4	3	1	-139	5.735
34	Hani i Elezit	10.090	7	62	-55	37	42	-5	-60	10.030
35	Graçanicë	12.230	13	64	-51	167	107	60	9	12.239
36	Ranillug	3.737	2	12	-10	8	6	2	-8	3.729
37	Partesh	1.699	1	10	-9	5	4	1	-8	1.691
38	Kllokot	2.719	3	21	-18	16	11	5	-13	2.706
	Gjithsej	1.798.186	4.122	42.728	-38.606	7.353	7.353	0	-38.606	1.759.580

Tabela 3. Gjithsej popullsia e Kosovës e vlerësuar për vitin 2021 në nivel të komunave

Nr.	Komuna	Gjithsej popullsia e vlerësuar (31 dhejtor 2020)	Shtimi natyror (2021)	Bilanci i migrimeve (2021)	Rritja e përgjithshme(shtimi natyrot dhe migrimi) për vitin 2021)	Gjithsej popullsia e Kosovës e vlerësuar për vitin 2021 (31 dhjetor 2021)
1	Deçan	42.480	275	-265	10	42.490
2	Gjakovë	94.334	590	-2.097	-1.507	92.827
3	Glogoc	61.145	794	-1.218	-424	60.721
4	Gjilan	77.145	485	-4.112	-3.627	73.518
5	Dragash	33.947	87	-552	-465	33.482
6	Istog	41.181	216	-278	-62	41.119
7	Kaçanik	34.672	316	-321	-5	34.667
8	Klinë	40.490	423	-738	-315	40.175
9	Fushë Kosovë	39.948	484	-1.175	-691	39.257
10	Kamenicë	27.948	69	-1.851	-1.782	26.166
11	Mitrovicë	69.331	535	-1.628	-1.093	68.238
12	Mitr. e Veriut	11.994	-7	-105	-112	11.882
13	Leposaviq	13.202	-28	-293	-321	12.881
14	Lipjan	57.928	673	-1.144	-471	57.457
15	Novobërdë	7.158	-1	-87	-88	7.070
16	Obiliq	18.218	201	-1.155	-954	17.264
17	Rahovec	57.047	528	-2.184	-1.656	55.391
18	Pejë	98.601	472	-1.802	-1.330	97.271
19	Podujevë	82.022	996	-2.496	-1.500	80.522
20	Prishtinë	218.781	1.542	-1.306	236	219.017
21	Prizren	194.581	1.300	-2.075	-775	193.806
22	Skenderaj	52.714	563	-691	-128	52.586
23	Shtime	27.449	330	-825	-495	26.954
24	Shtërpcë	6.621	-41	-77	-118	6.503
25	Suharekë	58.195	683	-2.512	-1.829	56.366
26	Ferizaj	106.286	1.092	-1.715	-623	105.663
27	Viti	47.896	394	-817	-423	47.473
28	Vushtrri	62.925	548	-2.459	-1.911	61.014
29	Zubin Potok	6.664	-14	-45	-59	6.605
30	Zveçan	7.290	-55	-43	-98	7.192
31	Malishevë	57.261	893	-2.276	-1.383	55.878
32	Junik	6.383	21	-45	-24	6.359
33	Mamushë	5.874	75	-139	-64	5.810
34	Hani i Elezit	10.090	81	-60	21	10.111
35	Graçanicë	12.230	-81	9	-72	12.158
36	Ranillug	3.737	-31	-8	-39	3.698
37	Partesh	1.699	-16	-8	-24	1.675
38	Klllokot	2.719	-1	-13	-14	2.705
Gjithsej		1.798.186	14.391	-38.606	-24.215	1.773.971

Agjencia e Statistikave te Kosovës: Përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 01.07.2020 ky Agjencion vepron në kuadër Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Me vendimin e datës 22.06.2022 ASK kalon përsëri tek Zyra e Kryeministrit. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili kua hyrë në fuqi me 12.12.2011 si dhe Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-058 i cili ka hyrë në fuqi me 17.01.2019. Programi i Statistikave Zyrtare, 2018/2022 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: **Departamentet prodhuese;** *Departamenti i statistikave ekonomike, Departamenti i llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit dhe Departamenti i statistikave sociale.* **Departamentet mbështetëse;** *Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës.* **Ne kuadër të Agjencionit veprojn edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Të punësuar janë gjithsej 156 punëtorë, prej tyre, 115 në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 41, Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 123 me shkollim universitar, 15 me shkollim të lartë, ndërsa 18 me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njërive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruer terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Rregjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

Adresa:

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë

Telefoni:

+383 (0) 38 200 31 129

Kryeshefi Ekzekutiv:

+383 (0) 38 200 31 112

Fax:

+383 (0) 38 235 033

E-mail:

infoask@rks-gov.net

Ueb-faqe:

<http://ask.rks-gov.net>